



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

---

Nr. 11840 Prot.,

Tiranë, më 15. 5.2026

**Lënda: Udhëzim për përcaktimin e afatit dhe procedurën e aplikimit për lidhjen e marrëveshjes së paqes fiskale për vitin tatimor 2026**

Në zbatim të pikës 1, të nenit 11 dhe pikës 2, të nenit 14, të ligjit 84/2025, “Për Marrëveshjen e Paqes Fiskale”, si dhe me qëllim garantimin e zbatimit të njëtrajtshëm të procedurës së aplikimit për vitin e parë tatimor të zbatimit të këtij ligji, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve harton këtë udhëzim i cili synon zbatimin në praktikë të detyrimeve ligjore të parashikuara, përcaktimin e veprimeve konkrete dhe afatet proceduriale lidhur me aplikimet për lidhjen e marrëveshjes së paqes fiskale për vitin e parë tatimor të zbatimit të këtij ligji.

### **1. Afati i aplikimit.**

Për vitin tatimor 2026, aplikimi për lidhjen e Marrëveshjes së Paqes Fiskale mund të kryhet elektronikisht nga data **15.05.2026** deri më datë **05.06.2026**. Aplikimet e kryera pas këtij afati do të refuzohen.

### **2. Mënyra e aplikimit.**

Tatimpaguesit që plotësojnë kushtet ligjore, paraqesin kërkesën elektronikisht nëpërmjet sistemit e-filing, në rubrikën: “Çështjet e mia” – “Pyetje e përgjithshme” duke vendosur titullin: “Aplikim për Marrëveshjen e Paqes Fiskale” dhe duke ngarkuar, formularin e aplikimit “Për lidhjen e Marrëveshjes së Paqes Fiskale”, të plotësuar, sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur udhëzimit Nr. 10, datë 14.5.2026, “Për Procedurat e marrëveshjes së paqes fiskale”. Aplikimi konsiderohet i dorëzuar në momentin e konfirmimit të regjistrimit nga sistemi dhe marrjes së një numrit unik të çështjes.

### 3. Plotësimi i dokumentacionit.

Në rast se gjatë verifikimit paraprak konstatohet mungesë apo pasaktësi e të dhënave të deklaruara, tatimpaguesi njoftohet elektronikisht për plotësimin e tyre brenda një afati prej **3 ditë pune**. Mosplotësimi i dokumentacionit brenda këtij afati sjell mospranimin e aplikimit (refuzimin).

### 4. Trajtimi i aplikimit dhe njoftimi i rezultatit.

Pas verifikimit të kushteve ligjore sipas Ligjit nr. 84/2025 “Për marrëveshjen e paqes fiskale” dhe Udhëzimit Nr. 10, datë 14.5.2026, “Për Procedurat e marrëveshjes së paqes fiskale”, dalë në zbatim të tij, **brenda 5 ditëve kalendarike**, por jo më vonë se data **10.06.2026**, vendimmarrja mbi aplikimin i komunikohet tatimpaguesit në mënyrë elektronike në llogarinë e tij në sistemin e-filing.

Në rastin e plotësimit të kushteve ligjore, hartohet “Marrëveshja e paqes fiskale”, e cila nënshkruhet nga titullari i drejtorisë rajonale tatimore, ku tatimpaguesi është i regjistruar, dhe i vihet në dispozicion tatimpaguesit.

Brenda **5 ditëve kalendarike**, por jo më vonë se **data 15.06.2026**, dokumenti i nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor/administratori i tatimpaguesit ose personi fizik dorëzohet me çështje në e-filing.

Aplikuesit, të cilët në formularin e aplikimit për lidhjen e marrëveshjes së paqes fiskale, kanë deklaruar që do të kryejë rideklarimin e pasqyrave financiare për një ose disa nga vitet tatimore sipas përcaktimit në ligj (2023, 2024, 2025), pas lidhjes së marrëveshjes dhe rideklarimit/korrigjimit të deklaratave vjetore përkatëse, **brenda datës 30.06.2026** duhet:

- Të kryejnë pagesën e tatimit në kuptim të Ligjit nr. 84/2025 “Për marrëveshjen e paqes fiskale”, për çdo vit tatimor për të cilin është ndryshuar deklarata tatimore, për deklaratat e vitit 2023, 2024 dhe 2025.
- Të dorëzojnë pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore të juridiksionit elektronikisht në e-filing, formularin e aplikimit për rideklarimin e elementeve të veçanta të aktiveve, të detyrimeve apo të kapitaleve të veta të pasqyrave financiare vjetore sipas shtojcës nr. 2 të udhëzimit Nr. 10, datë 14.5.2026, “Për Procedurat e marrëveshjes së paqes fiskale”.
- Të dorëzojnë pasqyrat financiare të rideklaruara në format PDF dhe Excel dhe të nënshkruara nga përfaqësuesi ligjor/administratori ose personi fizik.
- Pasqyrat e rideklaruara duhet të dorëzohen me çështje në e-filing me emërtesën: *Ndryshimi i pasqyrave financiare sipas Ligjit Nr. 84/2026, “Për marrëveshjen e paqes fiskale”, për vitin: 2023, 2024, 2025.*

- Për çdo ndryshim të kryer tek pasqyrat financiare, duhet të bëhen sqarimet përkatëse bazuar në legjislacionin për kontabilitetin.
- Administrata tatimore rezervon të drejtën për të kërkuar informacione shtesë në lidhje me ndryshimet e reflektuara në pasqyrat financiare dhe deklaratat vjetore përkatëse.

## 5. Publikimi.

Ky udhëzim publikohet në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe hyn në fuqi menjëherë.

## DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Ilir Binaj

